




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT
PROKURORIAL TË
KOSOVËS 2024**



Prishtinë, 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicionin pasqyrohen aktivitetet e KPK-
së për muajin korrik të vitit 2024)

Zëvendëskryesuesja e KPK-së merr pjesë në publikimin e Raportit të OSBE-së për monitorimin e gjyqimeve të rasteve të dhunës në familje në Kosovë

Prishtinë, 2 korrik 2024 - Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, së bashku me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj dhe Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Rexhepi, mori pjesë në takim dhe organizuar nga OSBE-ja për prezantimin e Raportit të monitorimit të gjyqimeve të rasteve të dhunës në familje në Kosovë për periudhën janar-dhjetor 2023.

Në këtë takim është diskutuar për Raportin e monitorimit të gjyqimeve të rasteve të dhunës në familje në Kosovë për periudhën janar-dhjetor 2023 dhe rekomandimet e BE-së lidhur me këtë raport.



Më këtë rast, Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Grantolli, theksoi se Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit në vazhdimësi kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të angazhuar në trajtimin sa më të mirë të këtyre rasteve, duke e ditur ndjeshmërinë e madhe që ka kjo kategori, duke i trajtuar të njëjtat me prioritet dhe njëherësh falënderoi të gjithë prokurorët të cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje për punën e madhe që bëjnë. “Gjithashtu ajo ka theksuar se për shkak të mostrajtitimit të duhur të këtyre rasteve, tashmë, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka ndërmarrë edhe masën më të rëndë - propozimin për shkarkim nga detyra të një prokurori të shtetit.

Znj Grantolli ka theksuar në përfundim se Këshilli Prokurorial i Kosovës mbetet i përkushtuar që rastet nga kjo kategori t’i trajtojë me prioritet, efikasitet dhe llogaridhënie.

Drejtori Istrefi mban takimin e radhës më zyrtarët për komunikim publik

Prishtinë, 3 korrik 2024 – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK), Sami Istrefi, mbajti takimin e radhës me zyrtarët e komunikimit publik në sistemin prokurorial, në të cilin mori pjesë edhe Shefi i Kabinetit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Ardian Nikolla dhe Udhëheqësi i DTI-së në SKPK, Nexhat Haziri.



Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, duke shprehur mbështetjen e tij të plotë për punën dhe angazhimin e zyrtarëve për komunikim publik, ka theksuar se brenda mundësive ligjore dhe buxhetore ka adresuar sfidat kryesore për përmirësimin e kushteve të punës së zyrtarëve për komunikim publik. “Kohëve të fundit janë miratuar nga KPK-ja një pjesë e akteve normative për stafin administrativ në sistemin prokurorial dhe një pjesë tjetër është në proces e sipër, akte këto, që fuqizojnë dhe mbështesin edhe rolin dhe rëndësinë e punës së zyrtarëve të komunikimit”, tha me këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së.

Diskutimet e Drejtorit Istrefi me zyrtarët për komunikimin shtruan gjithashtu nevojën e angazhimit të zyrtarëve për komunikim publik për listimin e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve profesionale me anë të trajnimeve specifike, unifikimin e informacioneve kryesore, të cilat publikohen në rrjetet sociale dhe në faqet zyrtare të sistemit prokurorial.

Në vijim të takimit janë adresuar disa çështje organizative të njësive të komunikimit publik dhe zyrtarëve përkatës, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e performancës dhe prezantimin sa më të mirë të punës së sistemit prokurorial para publikut, sidomos me anë të pasurimit me informacione relevante, kurse në përmbyllje të takimit të sotëm është nënvizuar se do të nxjerrën konkluzionet e radhës për hapat e mëtejshëm, të cilët do të ndikojnë në fuqizimin e transparencës publike nëpërmjet një komunikimi më proaktiv dhe më gjithëpërfshirës me mediat dhe shoqërinë civile.





Urimi i Kryesuesit Hajdaraj drejtuar Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesisë së Tij, z. Jeffrey M. Hovenier

4 korrik 2024

Inderuari z.Hovenier,

Një urim i ngrohtë për shënimin e 248-vjetorit të Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës!

Kjo është një ditë e rëndësishme për të festuar historinë dhe arritjet e mrekullueshme të vendit tuaj. Ua dërgoj mirënjohjen dhe respektin tim për këtë datë të rëndësishme në historinë botërore.

Gëzuar Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës!

Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është një ngjarje e cila përjetohet me ndjenja të veçanta vlerësimi dhe mirënjohjeje nga populli i Kosovës.

Ekziston një lidhje e veçantë midis popullit të Kosovës dhe Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pasi Shtetet e Bashkuara kanë qenë një mbështetës i rëndësishëm dhe një aleat i fortë në rrugën drejt pavarësisë së Kosovës.





Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka një ndjenjë të thellë mirënjohjeje dhe respekti për Shtetet e Bashkuara të Amerikës pasi që mbështeten dhe vazhdojnë ta mbështesin Kosovën në krijimin e demokracisë, duke u bazuar në modelin e tyre shtetëror mbi vlerat universale të lirisë, demokracisë dhe prosperitetit.

Shpreh mirënjohjen më të thellë për bashkëpunimin e ngushtë që Këshilli Prokurorial i Kosovës ka me Departamentin Amerikan të Drejtësisë përmes projekteve dhe programeve të shumta në mbështetje të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve në Kosovë. Jam i bindur se do të

zhvillojmë edhe më tej bashkëpunimin konstruktiv në këtë fushë dhe do të shtojmë kapacitetet e sistemit prokurorial për luftimin e çdo lloj veprimtarie kriminale.

Z. Hovenier, Ju uroj shëndet të mirë dhe suksese, si dhe paqe dhe prosperitet për popullin amerikan.

Me respekt,
Ardian Hajdaraj
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 8 korrik 2024

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së dhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Kosovë.

Qëllimi i takimit të sotëm ishte draftimi i Rregullores për Zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në të cilën përcaktohet procedura e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve dhe zëvendëskryeprokurorëve të prokurorive të vendit dhe udhëheqësve të departamenteve.



Gjithashtu në këtë takim është formuar edhe Grupit punues për hartimin e Rregullores për Ekipe të Përbashkëta Hetimore, i cili rrjedh nga Memorandumi i Bashkëpunimit mes Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Kosovë, të datës 23 maj 2024, përmes të të cilit parashihet krijimi i ekipeve të përbashkëta hetimore për të siguruar hetime efikase të veprave penale komplekse.

Kryesuesi Hajdaraj priti në takim lamtumirës Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane, z. Hanley

Prishtinë, 9 korrik 2024 - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, së bashku me Zëvendëskryesuesen e KPK-së, znj. Jehona Grantolli dhe Drejtorin e Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi, priti në një takim lamtumirës Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë, z. John Hanley, i cili shoqërohej nga Këshilltari Rezident Ligjor, z. Erin Cox dhe Specialistja e Lartë Ligjore në OPDAT, znj. Benina Kusari.



Më këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj falënderoi z.Hanley për angazhimin dhe përkushtimin e madh që kishte në bashkëpunim me përfaqësuesit e sistemit prokurorial për avancimin, fuqizimin e transparencës, llogaridhënies dhe për të punuar së bashku në drejtim të avancimit dhe rritjes së besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial.

Gjithashtu, z.Hanley, vlerësoi bashkëpunimin, punën dhe përkushtimin e përfaqësuesve të KPK-së për intensifikimin e angazhimeve për të arritur progresin e dëshiruar në forcimin e transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial.

Në fund të takimit, z.Hanley iu ndanë mirënjohje në shenjë respekti dhe falënderimi për kontributin e tij dhënë sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.



Mbahet takimi i radhës i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 11 korrik 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti takimin e 250-të me radhë.

Gjatë takimit të sotëm, anëtarët e KPK-së kanë marrë vendimet si në vijim:

- Miratuan dy raporte të Koordinatorit për Luftimin e Krimeve Ekonomike për periudhat kohore tetor-dhjetor 2023 dhe janar-mars 2024;
- Miratuan Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën e Sistemit Prokurorial, së bashku me shtojcën përkatëse;
- Miratuan Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve për procesin e avancimit të një prokuroreje në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe në këtë departament avancuan prokuroren Leonora Kadriu;
- Miratuan Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve për procesin e avancimit të një prokurori në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe në këtë departament avancuan prokurorin Besnik Nuredini;



- Miratuan Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve për procesin e avancimit të gjashtë prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe refuzuan kundërshtimin e paraqitur nga një kandidat ndaj këtij raporti dhe në këtë departament avancuan prokurorët: Arianit Salihu, Luljeta Bilalli, Eset Rama, Besnik Jakupi, Elza Bajrami – Kastrati dhe Menduhi Kastrati;
- Miratuan dërgimin e propozimit të Presidentja e vendit për lirim nga detyra me rastin e pensionimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Ismet Ujkani, si dhe caktuan prokurorin Njazi Rexha Ushtrues të Detyrës së Kryeprokurorit të kësaj prokurorie, duke filluar nga 2 gushti 2024;
- Miratuan dërgimin e propozimit të Presidentja e vendit për lirim nga detyra me rastin e pensionimit gjatë muajit gusht 2024 të dy prokurorëve: Afrim Shefkiu (Prokuroria Speciale) dhe Zejnie Kela (Prokuroria Themelore në Mitrovicë);
- Caktuan prokurorin Fatmir Behrami në detyrën e Udhëheqësit të Departamentit për të Mitur dhe prokurorin Bashkim Zeqa në detyrën e Udhëheqësit të Departamentit për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.



Kryesuesi Hajdaraj priti në takim Drejtorin e Akademisë së të Drejtës Evropiane (ERA), z.Jean-Philippe

Prishtinë, 15 korrik 2024 - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Ardian Hajdaraj, së bashku me Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z.Besim Kelmendi dhe Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, z.Enver Fejzullahu, priti në takim Drejtorin e Akademisë së të Drejtës Evropiane (ERA), z.Jean-Philippe, me bashkëpunëtorë.

Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe për intensifikimin e aktiviteteve të Akademisë së të Drejtës Evropiane, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të sistemit prokurorial për zbatimin e të drejtës së BE-së.

Fillimisht, Kryesuesi Hajdaraj ka njoftuar z.Jean-Philippe për nevojat e sistemit prokurorial në fushën e ngritjes së kapaciteteve profesionale, duke theksuar se sistemi prokurorial përbëhet nga prokurorë të rinj dhe se janë të mirëpritura trajnimet specifike, sidomos ato që ndërlidhen me temat e luftimit efikas të korrupsionit, shpëlarjes së parasë, krimeve kibernetike dhe krimit të organizuar.

Gjatë diskutimeve të Kryesuesit të KPK-së. Ardian Hajdaraj dhe U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, me Drejtorin e ERA, z.Jean-Philippe, është kërkuar që në trajnimet online që organizohen nga ERA të marrin pjesë prokurorët dhe, njëkohësisht, të shfrytëzohen materialet trajnuese që publikohen në uebfaqen e kësaj akademie evropiane.

Programet e Akademisë së të Drejtës Evropiane (ERA) ndihmojnë vendet e Ballkanit Perëndimor me trajnime për rritjen e kapaciteteve, duke aftësuar dhe përgatitur prokurorët dhe gjyqtarët e vendeve rajonale në zbatimin e së drejtës së BE-së.



KPK-ja reagon ndaj miratimit të Projektligjit të ri për KPK-në nga Kuvendi I Kosovës

Prishtinë, 15 korrik 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) njofton opinionin publik se Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka injoruar dhe refuzuar komentet, sugjerimet dhe propozimet e përfaqësuesve të deleguar të KPK-së në grupet punuese, të formuara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe në komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të ri për KPK-në, i cili është miratuar më 11 korrik 2024.

Kjo praktikë e njëanshme e miratimit të akteve ligjore, tregon qartazi se Qeveria e Kosovës dhe shumica në Kuvendin e Kosovës, me vetëdije dhe në emër të reformave, synojnë të bëjnë të kundërtën e reformës, pra bllokimin dhe defunksionalizimin e sistemit prokurorial.



KPK-ja thekson se miratimi i këtij ligji përbën mosrespektim dhe shkelje të hapur të parimeve kryesore të Deklaratës së Përbashkët të Zotimit, që, në vetvete, paraqet një lloj absurditeti të llojit të rrallë, ngaqë përbërja e Ekzekutivit aktual, gjegjësisht, Ministria e Drejtësisë, nuk po arrin assesit të shmangë qëndrimet politike në raport me sistemin prokurorial, duke mos përfillur sugjerimet e shumanshme dhe duke rënë në kundërshtim jo vetëm me kërkesat e bazuara të përfaqësuesve të KPK-së, por edhe me kërkesat dhe rekomandimet e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Megjithatë, KPK-ja është mirënjohëse dhe falënderuese në mënyrë të veçantë ndaj përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile në vend, të cilët u vunë në mbrojtje të këtyre parimeve dhe insistuan me ngulm që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të mos injorojnë rekomandimet e institucioneve vendore, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe OSBE-së sa i përket Projektligjit për Këshillin Prokurorial.

Me këtë rast, KPK-ja është bashkuar plotësisht me thirrjet dhe apelet kuptimplota për respektimin e normave dhe standardeve evropiane para miratimit të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në Kuvend, duke kritikuar ashpër qasjen e pushtetit lidhur me cenimin e pavarësisë së institucioneve kushtetuese të vendit, siç është KPK-ja.

Realisht, kjo tendencë e pushtetit, e zbuluar tashmë plotësisht, paraqet ndërhyrje rigoroze në sistemin prokurorial dhe në tërë sistemin e drejtësisë, duke përtërirë çdo ditë veprime dhe lloj-lloj farsash dhe insinuatash, me qëllimin e vetëm që në emër të kinse synimit të fuqizimit të llogaridhënies më të madhe në sistemin prokurorial, të arrihet ekuilibri i përbërjes me anëtarë prokurorë dhe joprokurorë, por që, në vetvete është tentim për kapjen dhe dirigjimin e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit dhe cenon mandatin kushtetues dhe pavarësinë e sistemit prokurorial, duke pamundësuar funksionalizimin e tij dhe duke e bërë atë lehtësisht të ndikuar nga politika.

Përfundimisht, Këshilli Prokurorial i Kosovës, potencon se mbetet i përkushtuar për të mbështetur proceset reformuese dhe angazhohet që së bashku me të gjithë partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, të bashkëveprojë në çdolloj nisme që ka për qëllim reformimin e nevojshëm, në mënyrë që të fuqizohet sundimi i ligjit në Kosovë dhe sistemi prokurorial të bëjë punën e vet të pavarur, profesionale, llogaridhënëse dhe transparente, por njëkohësisht kërkon edhe respektimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mënjanimin e çfarëdo tendence për kapjen antikushtetuese të institucioneve të pavarura të vendit.

Kryesuesi Hajdaraj viziton prokuroritë themelore në Ferizaj dhe në Gjilan

Prishtinë, 16 korrik 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, së bashku me anëtarët e KPK-së, Armend Zenelajn dhe Jetish Malokun, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, vizitoi sot prokuroritë themelore në Ferizaj dhe në Gjilan, ku është pritur nga kryeprokurorët Shukri Jashari dhe Arben Kadriu, me bashkëpunëtorët e tyre.

Në të dyja takimet e zhvilluara, Kryesuesi Hajdaraj u njoftua nga kryeprokurorët e prokurorive themelore në Ferizaj dhe në Gjilan për aktivitetet e zhvilluara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 dhe për proceset aktuale të punës. Me këtë rast, ata adresuan edhe sfidat e ndryshme gjatë procesit të punës për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale në territorin që kanë në kompetenca të tyre.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial falënderoi kryeprokurorët për informatat e prezantuara, duke theksuar nevojën e diskutimeve për zbatimin e mandateve të tyre kushtetuese dhe ligjore. “Ne presim angazhimin tuaj për trajtimin me prioritet të rasteve të dhunës në familje dhe rasteve të tjera specifike”, nënvizoi Kryesuesi Hajdaraj.

Kryesuesi Hajdaraj dhe kryeprokurorët Jashari dhe Kadriu janë pajtuar për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës, mbajtjen e trajnimeve të specializuara, zbatimin e planeve të punës dhe angazhimin e gjithanshëm për fuqizimin e sundimit të ligjit në vendin tonë.



Miratohet Raporti financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024

Prishtinë, 18 korrik 2024 - Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit dhe udhëheqësit e njësjive organizative për buxhet, financa, administratë dhe shërbime të përgjithshme.



Qëllimi i takimit ishte shqyrtimi i Raporti Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, me ç'rast u trajtuan shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Më pas, Raport financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 është miratuar nga anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, pa asnjë ndryshim.



Mbahet takimi i radhës I Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 18 korrik 2024 - Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së dhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Kosovë.



Gjatë këtij takimi është bërë finalizimi i draftit fillestar të Rregullores për Zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në të cilën përcaktohet procedura e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve dhe zëvendëskryeprokurorëve të prokurorive të vendit dhe udhëheqësve të departamenteve.

Po ashtu, anëtarët e Komisionit janë pajtuar që ky draft i kësaj rregulloreje të dalë në dëgjim publik.



Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 29 korrik 2024 – Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i kryesuar nga z.Jetish Maloku, mbajti sot takimin e radhës sipas agjendës së paraparë.

Në këtë takim morën pjesë anëtarët e Komisionit dhe të grupit punues për përgatitjen e Udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, z.Mats Persson, Koordinatori i Komisioneve të Përherëshme të KPK-së, zyrtarët e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë dhe të Departamentit të Teknologjisë Informative të Sekretariatit të KPK-së.

Fillimisht, udhëheqësi i grupit punues për përgatitjen e Udhëzuesit për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Admir Shala, prezantoi draftin e Raportit për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, përfshirë konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.



Anëtarët e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, vlerësuan se Drafraporti mund të ndihmojë në standardizimin dhe përmirësimin e procedurave për trajtimin e këtyre rasteve, si dhe rekomanduan ngritjen e nivelit të cilësisë së të dhënave në Prokurorinë e Apelit, si dhe diskutuan edhe për vizitat që do t'i realizojnë në të gjitha prokuroritë e vendit, ku do të mbikëqyrin zhvillimin e procesit të punës përmes SMIL-it dhe do të identifikojnë nevojat e infrastrukturës fizike.

